



Informacione për prindërit – Përkrahje integrale (IF)

Të dashur prindër

Nxënëset dhe nxënësit janë të ndryshëm. Interesat dhe niveli i zhvillimit, kushtet paraprake dhe nevojat, talentet dhe prirjet por gjithashtu vështirësitë e vogla ose të mëdha, janë të ndryshme nga fëmija në fëmijë. Mësuesit e klasave të rregullta mundohen që ti përkrahin mundësitë e çdo fëmije në mënyrë të drejtë. Ata mbështeten në kuadër të përkrahjes integrale nga pedagogët shkollor shërues (SHP).

Çfarë janë nevojat e veçanta pedagogjike?

Tek fëmijët dhe të rinjtë, të cilët qëllimet mësimore të nivelit shkollor përkatës i arrijnë pjesërisht me mundim të madh ose nuk i arrijnë fare, në këtë rast bëhet fjalë për „një nevojë të veçantë pedagogjike“. Një nevojë e veçantë pedagogjike mund të ekzistoj gjithashtu edhe të nxënësit e talentuar të cilët ndjehen të pa ngarkuar siç duhet. Këta nevoja mund të shfaqen përkohësisht ose të zgjasin gjithashtu një kohë të gjatë. Nëse kërkesat e shkollës dhe kushtet paraprake të një nxënësi nuk përputhen, atëherë masat e qëllimshme përkrahëse janë të domosdoshme në kuadër të përkrahjes integrale (IF).

Çfarë mund të bëj shkolla?

Tek mësimi në klasën e rregullt, bashkëpunimi ndërmjet mësuesit të klasës dhe pedagogut të shkollës (SHP) është me shumë rëndësi. Së bashku duhet që sa më shpejt që të jetë e mundur të dallohen nevojat e veçanta pedagogjike.

Nëse vërehen ose supozohen nevojat e veçanta pedagogjike, atëherë mësuesi i shkollës i fton prindërit në një bisedë në shkollë, eventualisht një pedagog të shkollës (SHP) ose një terapist, në varësi të moshës edhe nxënësin. Në këtë takim diskutohen dhe protokollohen nevojat, qëllimet si dhe mënyra e veprimit. Nëse ka nevojë për sqarime të më tejshme ose nëse nuk bihet dakord ndërmjet palëve, atëherë përfshihet edhe shërbimi psikologjik shkollor.

Nëse ka devijime të mëdha ndërmjet qëllimeve individuale nga qëllimet mësimore të klasës përcaktohen sipas rregullit pas një sqarimi psikologjiko shkollorë – në kuadër të bisedës në shkollë, qëllime individuale mësimore. Në këtë rast mund të hiqet dorë nga vënia e notës në dëftesë, të një ose më shumë lëndëve dhe në vend të saj mund të lëshohet një raport mësimor.

Së shumti pas një viti verifikohen masat e marra në një bisedë tjetër në shkollë.

Cfarë është përkrahja integrale (IF)?

Mësuesi i kualifikuar i posaçëm përkrahës (SHP) ndjek veçanërisht mësimin në kopsht dhe në ciklin e ulët rregullisht ose kohë pas kohe. Nga bashkëpunimi i tij përfitojnë nxënëset dhe nxënësit dhe forcohet e gjithë shkolla në tërësi. Kështu i shoqërojnë mësuesit e klasës dhe pedagogët e shkollës nxënëset dhe nxënësit e të gjitha niveleve dhe klasave në rrugën e tyre mësimore.

Përkrahja integrale e mbështet shkollën ose nxënëset/nxënësit veç e veç posaçërisht tek sfidat në vijim:

- mësim i përgjithshëm (p.sh. vëmendja, kujtesa, strategjia e mësimit dhe e zgjidhjes së problemeve)
- shkrimi dhe leximi (duke përfshirë mësimin e gjuhës dhe formimin e nocioneve, problematikën e drejtleximit dhe të drejtshkrimit)
- mësimi i matematikës (dobësi në llogaritje)
- sjellja më kërkesat (p.sh. motivimi, lidhja me detyrat, drejtimi i sjelljes vetjake, sjellja me ndjenjat si gëzimin dhe frustrimin)
- mos ngarkesa e duhur tek fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të theksuara
- sjellja me njerëzit (kompetenca sociale dhe ajo e sjelljes, rregullimi i afërsisë dhe distancës)

Përkrahja bazohet në cilësitë e fëmijëve dhe të rinjve. Ajo u përshtatet nevojave të tyre dhe i përkrah ata në zhvillimin e tyre shkollorë dhe social. Ky shoqërim mund të zhvillohet brenda ose jashtë njësisë së klasës, vetëm ose në grup.

Edhe mësuesit mbështeten gjithashtu nga pedagogët e shkollës (SHP) në punën e tyre përkrahëse dhe integrale. Kjo ndodh për shembull nëpërmjet planifikimit dhe udhëheqjes së mësimit (Teamteaching), nëpërmjet vëzhgimit të procesit mësimor të nxënësve, nëpërmjet vënies në dispozicion të materialeve të përshtatshme mësimore dhe zgjedhjes së përshtatshme të formës së mësimit. Pedagogët e shkollës (SHP) hartojnë plane përkrahëse individuale dhe shkruajnë në komunikim me mësuesin e klasës raportin mësimor.

Disa nxënësve u nevojitet një terapi e caktuar ndihme (krahaso: informacione për prindër «Logopedia» dhe «Psikomotorika») ose përkrahja tek mësimi i gjermanishtes si gjuhë e dytë (krahaso: informacione për prindër «DaZ»). Komuna të ndryshme ofrojnë krahas kësaj oferta shtesë për shumë të talentuarit (krahaso. Informacione për prindër «Përkrahja e talentëve»), ndihmë në detyrat e shtëpisë ose përkujdesje ditore.

Cfarë mund të bëjnë prindërit

Problemet të cilat kanë ndikim në sjelljen mësimore të fëmijës ose të të riut, mund të zgjidhen vetëm nëse prindërit dhe mësuesit bashkëpunojnë. Interesohuni për këtë dhe merrni pjesë aktiv në ndodhitë shkollore të fëmijës tuaj dhe mos nguroni nëse keni pyetje, për të biseduar më mësuesin e klasës,.

Në qoftë se ju supozoni ose konstatoni një nevojë të veçantë pedagogjike të fëmijës tuaj, mund të kërkonte tek mësuesi i klasës një takim në shkollë. Në takim shkollor bihet dakord se si prindërit mund ta përkrahin fëmijën e tyre. Shumë vështirësi shfaqen gjithashtu në shtëpi, në përditshmëri ose në detyrat e shtëpisë. Është e rëndësishme që masat përkrahëse të marra nga prindërit të përputhen me ata të shkollës dhe të plotësohen reciprokisht.

Sot ka organizata prindërore në nivel kantonial dhe këshill prindëror në nivel komunal. Këtu jepen më tej informacione, shkëmbehen përvojat dhe kërkohen rrugëzgjdhje për fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të veçanta pedagogjike në shkollë, në shtëpi ose në zgjedhjen e profesionit.

Prindërit mund për këtë të këshillohen dhe të përkrahen nga zyrat përkatëse (p.sh. shërbime konsultimi psikologjiko shkollore, sekretariate për të rinjtë).

Informacion / konsultim

Shërbime konsultimi psikologjiko shkollore (adresat nën: www.vsa.zh.ch → Gesundheit & Prävention → Schulpsychologie)

Konsultime për familje dhe të rinj të sekretariateve për të rinj (adresat nën: www.ajb.zh.ch/JS)

Informacion «biseda në shkollë (Schulische Standortgespräche)» nën: www.vsa.zh.ch → Schulbetrieb & Unterricht → Sonderpädagogisches → Zuweisungsverfahren → Schulische Standortgespräche

Shoqata prindërore:

- Bashkimi i organizatave prindërore të kantonit të Cyrihut: www.vez.ch
- www.schule-elternhaus.ch
- www.verband-dyslexie.ch